



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Nr. ~~5387~~/prot.

Tiranë, më 24.11.2017

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1171, datë 02.04.2008.

SHOQËRISË “STONE GROUP ALBANIA” SHPK
Lagjia e Re , Ish Fusha e Druve Korçë

Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri” , Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë

AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë

Shoqëria “Stone Group Albania” shpk është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1171, datë 02.04.2008 për mineralin ranor silicore, në objektin “Plovisht”, Qarku Korçë.

Shoqëria juaj ka bërë kërkesë për revokimin e lejes minerare të sipërcituar me shkresën nr.13, datë 10.03.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.1586, datë 13.03.2017, duke argumentuar se janë mbaruar rezervat gjeologjike. Këtë kërkesë e keni drejtuar për dijeni edhe AKBN-së. mbi bazën e të cilës AKBN ka dërguar shkresën me nr.2348/1, datë 31.03.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.2041, datë 03.04.2017 për revokimin e lejes nr.1171, datë 02.04.2008, ku propozon revokimin e lejes me kërkesën e vetë shoqërisë bazuar në gërmat “c” dhe “b”, të pikës nr.2 të nenit 47 të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Në të njëjtën kohë nga AKBN-ja është kërkuar shoqërisë tuaj të paguani diferencë vlere për garancinë e rehabilitimit të mjedisit, që revokimi të plotësojë kushtet ligjore, kur revokimin bëhet me kërkesën e vetë shoqërisë.

Kushtin e mësipërm nuk e keni plotësuar, kështu me shkresën e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) nr.5808 datë 27.07.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.5387, datë 01.08.2017, është propozuar për revokimin të lejes nr.1171, datë 02.04.2008 për mineralin ranor silicore, në objektin

“Plovisht”, Qarku Korçë, sepse nuk është paguar garancia financiare e rehabilitimi të mjedisit, siç është përcaktuar në nenin 31, pika 5 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën “ç”, të pikës 1, të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1171 datë 02.04.2008 për mineral ranor silicore, në objektin “Plovisht”, Qarku Korçë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.1171, datë 02.04.2008, për mineralin ranor silicore, në objektin “Plovisht”, Qarku Korçë.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI
Damian Gjiku

